**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA FIER**

**Nr. ______/___Prot.** **Fier, më 06.11.2023**

**Lënda:** Formulari i njoftimit të fituesit ne perfundim te afateve te ankimimit për proceduren me objekt **"Rikonstruksioni i shkolles 9 vjecare "Naim Frasheri"** me burim financimi nga Buxheti i Qendres Ekonomike te Arsimit Fier dhe Bashkisë Fier.

**AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK**
**TIRANË**
**(për botim)**

---

**Shtojca 13**

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

***(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT )***

**Bashkia Fier**

**Data:** **06.11.2023**

**Drejtuar:** Bashkimit të operatorëve ekonomik BOE: **"AIDA CONSTRUCTION" SHPK** dhe **"EUROVIA "SHPKNJ**

**Adresa**: "Fier, Rr BRIGADA XI SULMUESE, LAGJIA APOLONIA, pallati ne krah te Drejtorise Rajonale te Tatimeve, 9301, Bashkia Fier"&"Tirane, Rruga Abdyl v Frasheri, Shkalla 1, Apartamenti 18, Zona Kadastrale 8270"

**NUIS: M03116403L & L91426009G**

* * *

Procedura e prokurimit: E hapur me mjete elektronike, me objekt **"Rikonstruksioni i shkolles 9 vjecare "Naim Frasheri".**

**Numri i referencës së procedurës**/lotit: **REF-76226-07-27-2023.**

**Përshkrim i shkurtër i kontratës**: **"Rikonstruksioni i shkolles 9 vjecare "Naim Frasheri"** me **fond limit**/vlera e pritshme e kontratave prej **53 276 944,17** *(pesedhjete e tre milion e dyqind e shtatedhjete e gjashte mije e nenteqind e dyzet e kater presje shtatembedhjete )* **leke pa TVSH** me burim financimi nga nga Buxheti i Ministrise se Arsmit dhe Sportit dhe Bashkise Fier , në perputhje me preventivat, sasitë, specifikimet teknike, termat e referencës dhe kushtet e përcaktuara në DST.

**Shënim**:

Në bazë të shkresës nr.3124/5 prot date 09.06.2023 protokolluar prane Bashkis Fier me nr.5041prot date 12.06.2023 me lende "Dergohet celja e fondeve ne grupin e shpenzimeve kapitale per projektin me cikel fianancimi 2023-2024" nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiare ,Ministria e Arsimit dhe Sportit ,Urdheri i Ministris se Arsimit dhe Sportit me nr.3124/1 prot date 15.05.2023 ,me nr.237,date 15.05.2023 "Per shperndarjen e financimit per projekte te reja me cikel financimi 2023-2024,nga programet "Arsimi Baze" dhe "Arsimi Mesem",per infrastrukturen shkolle" si dhe shkrese nr 9069/1 prot date 07.06.2023 me lende "Trasferim fondi per shpenzime kapitale" ardhur nga Drejtoria e Menaxhimit te Investimeve Publike ,Ministria e Finacave dhe Ekonomise , për financimin procedures të prokurimit publik me objekt **"Rikonstruksioni i shkolles 9 vjecare "Naim Frasheri",** objekti i prokurimit **do të kontraktohet dhe zbatohet me vlerë të plotë**, por financimi do te behet nga buxheti i Ministrise Pergjegjese per Arsimin dhe Bashkise Fier perkatesishte si me poshte:

**Për vitin 2023** do të financohet në vlerën prej **32 828 325** (*tridhjete e dy milion e teteqind e njezet e tete mije e treqind e njezet e pese*) **lekë me TVSH** ku financimi nga buxheti i Ministrise Pergjegjese per Arsimin eshte ne vleren **23 475 117** (*njezet e tre milion e katerqind e shtatedhjete e pese mije e njeqind e shtatembedhjete*) **lekë me TVSH** dhe financimi nga Bashkia Fier eshte **9 353 208** *(nente milion e treqind e pesedhjete e tre mije e dyqind e tete)* **leke me TVSH** ndërsa pjesa tjetër e kontratës do të financohet **në vitin buxhetor 2024,** në vleren **31 104 008** (tridhjete e nje milion e njeqind e kater mije e tete) **lekë me TVSH** ku financimi nga buxheti i Ministrise Pergjegjese per Arsimin eshte ne vleren **23 475 117** (*njezet e tre milion e katerqind e shtatedhjete e pese mije e njeqind e shtatembedhjete*) **lekë me TVSH** dhe financimi nga Bashkia Fier eshte **7 628 891** *(shtate milion e gjashteqind e njezet e tete mije e teteqind e nentedhjete e nje )* **leke me TVSH**.

Afati kohor për ekzekutimin e kontratës: **4** *(kater)* **muaj** (sipas grafikut te punimeve)**.**

Publikime të mëparshme *(nëse zbatohet)*: Buletini i Njoftimeve Publike *[*06 Nëntor *2023]*, *[Numri* 90*]*.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **PO**

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1.** Bashkimi i operatorëve ekonomik BOE : “2Z KONSTRUKSION” SHPK me NUIS J63229466K dhe “ULZA” SHPK me NUIS J67902928O. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 43 736 050.55 (*dyzet e tre milon e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e pesëdhjetë pikë pesëdhjetë e pesë*) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.

**2.** Bashkimi i operatorëve ekonomik BOE: “AIDA CONSTRUCTION” SHPK me NUIS M03116403L dhe “EUROVIA ”SHPKNJ me NUIS L91426009G. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 42 738 983.71 (*dyzet e dy milion e shtatëqind e tridhjetë e tetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre pikë shtatëdhjetë e një*) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.

**3.** Bashkimi i operatorëve ekonomik BOE: “Caushi M” SHPK me NUIS L88419801O dhe “K.M.K.” SHPK me NUIS L78223801E. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 48 665 574 (*dyzet e tetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër*) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.

4. Operatori ekonomik “FRONTIER CONSTRUCTION” SHPK me NUIS M11811020Q. Nuk ka ofertuar.

**5.** Bashkimi i operatorëve ekonomik BOE: “INA” SHPK me NUIS J61814009W dhe “XHENGO” SHPK me J64103171M. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 42 650 692 (*dyzet e dy milion e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e dy*) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.

**6.** Bashkimi i operatorëve ekonomik BOE: “COGREN” SHPK me NUIS J74818825K, “JOGI” SHPK me NUIS J63229478K dhe “SPEKTRI” SHPK me NUIS J62903555F. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 43 670 473 (*dyzet e tre milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tre)* lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.

**7.** Operatori ekonomik “LEON KONSTRUKSION” SHPK me NUIS K71820009I. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 52 209 632.41 (*pesëdhjetë e dy milion e dyqind e nëntë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e dy pikë dyzetë e një)* lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.

**8.** Operatori ekonomik “MODESTE” SHPK me NUIS J62903413B. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 44 045 164.26 (*dyzet e katër milion e dyzet e pesë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e katër pikë njëzet e gjashtë)* lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.

**9.** Operatori ekonomik “NIKA” SHPK me NUIS J76705047U. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 36 724 857.55 (*tridhjetë e gjashtë milion e shtatë qind e njëzet e katër mijë e tetë qind e pesëdhjtë e shtatë pikë pesedhjetë e pesë)* lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.

**10.** Operatori ekonomik “Shendelli” SHPK me NUIS K07924803N. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 42 990 349.71 (*dyzet e dy milon e nëntëqinddd e nëntëdhjetë mijë e treqind e dyzet e nëntë pikë shtatëdhjetë e një)* lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.

Nga pjesërmarrësit jane skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

❖ Nga verifikimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomik BOE: **“2Z KONSTRUKSION” SHPK me NUIS J63229466K dhe “ULZA” SHPK me NUIS J67902928O**, paraqitur në SPE (Sistemin e Prokurimit Elektronik), KVO konstatoi se:

1. Referuar Marveshjes së Bashkëpunimit (Për bashkimin e operatorëve ekonomik), datë 12.08.2023, të ngarkuar në SPE nga bashkimi i operatorëve ekonomik si më sipër**,** përqindja e pjesëmarrjes për realizimin e objektit është 38% për “2Z KONSTRUKSION” SHPK dhe 62% për ”ULZA”SHPK, ndërkohë referuar preventivit ndarës të punimeve kjo përqindje nuk është e njëjtë, ku rezulton se për OE ”2Z KONSTRUKSION” SHPK është 37.55% dhe për OE ”ULZA”SHPK është 62.45 %.

2. Në shtojcën 8 ”Formulari i Vetdëklarimit”, OE ”2Z KONSTRUKSION” SHPK ka deklaruar si drejtues teknik personat si më poshtë:

- Kozeta Dema, me profesion Inxhiniere Ndërtimi, e punësuar pranë shoqërisë në rolin e Drejtuesit Teknike, Inxhiniere Ndertimi + Përgjëgjes për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë.
- Frederik Zere, me profesion Inxhinier Elektrik, i punësuar pranë shoqërisë në rolin e Drejtuesit Teknik, Inxhinier Elektrik.
- Thoma Gramatiko, me profesion Inxhinier Hidroteknik, i punësuar pranë shoqërisë në rolin e Drejtuesit Teknik, Inxhinier Hidroteknik.

Ndërsa Z.Ervin Zoga, është deklaruar me profesion ”Pllakashtrues”, i punësuar pranë shoqërisë ”2Z KONSTRUKSION” SHPK në rolin epllakashtruesit.

Sa më sipër, në kundërshtim me ”Formulari e Vetdeklarimit” sipas shtojcës 8 të DST-së, administratori i shoqerise ”2Z KONSTRUKSION” SHPK, ka bërë deklarimin me përmbajtjen si më poshtë:

”*D E K L A R A T E*

*Unë, Administratori i operatorit ekonomik "2Z KONSTRUKSION"sh.p.k. , Zani ZOGA, deklaroj :*

*Operatori Ekonomik "2Z KONSTRUKSION" Deklaron se Drejturesi Teknik i Punimeve ne objekt është ing.**Ervin Zoga** , i përfshirë në licencën e shoqërisë shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm: diplomë, librezë pune dhe kontratë pune."*

3. Referuar Shtojcës 7 të DST-së, pika 2 "*Kriteret e veçanta të kualifikimit*", pika 2.3 "*Aftësitë teknike dhe profesionale/Kapaciteti teknik*", nuk është plotësuar pika 2.3.5/a, pasi nga ana e BOE "2Z KONSTRUKSION SHPK" dhe "ULZA" SHPK nuk është deklaruar asnjë informacion në lidhje me:

    - Elektroargano 1(një) copë
    - Gazogjen 1(një) copë
    - Vinç ekskavator 1(një) copë

4. Gjithashtu, në Preventivin e paraqitur në SPE (Sistemin e Prokurimit Elektronik), konkretisht:
    - Preventivi "Punime hidraulike dhe mnz në objektin ekzistues dhe shtesën anësore", emërtimi i punimeve: "Kanalizimet e ujravetëshiut", zëri me numër rendor 7 është pasqyruar *"**Shtresë zhavorri**"* ndërkohë që ky zë në preventivin e AK është kërkuar*"**Shtresë rëre**".*
    - Në preventivin "Palestër e shkollës "Naim Frashëri", në emërtimin e punimeve "Punime shtresash", në zërin me numër rendor 4, 5 dhe 6 janë ndryshuar numrat e analizës.
    - Në preventivin "Palestër e shkollës "Naim Frashëri", në emërtimin e punimeve "Punime të brendëshme ndërtimore", në zerin me numër rendor 3, me numër analize 2.310/1, nga *"Suva brendamur tulle h-4m me **pompe** llac të përzier M25"* është bërë *"Suva brendamur tulle h-4m me **krahë** llac të përzier M25".*
    - Në preventivin "Punime Elektrike", në zerat me numër rendor 9 dhe 15, janë ndryshuar numrat e analizës.
    - Në preventivin "Punime hidraulike dhe mnz në objektin ekzistues dhe shtesën anësore", emërtimi i punimeve "Furnizimi me ujë Sanitar dhe Kanalizimi i Ujrave të zeza në zërin 2, 3, 4 F.v tuba rakorderi ujësjellës……..", **PN 10** është bërë **PN 11, PN 12,PN13.**

- Në preventivin“Punime hidraulike dhe mnz në objektin ekzistues dhe shtesën anësore”, emërtimi i punimeve “Furnizimi me ujë Sanitar dhe Kanalizimi i Ujrave të zeza”, zërit me numër rendor 30 i është ndryshuar numri i analizës.

❖ Nga verifikimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomik BOE: **“Caushi M” SHPK, me NUIS L88419801O dhe “K.M.K” SHPK me NUIS L78223801E**, paraqitur në SPE (Sistemin e Prokurimit Elektronik), KVO konstatoi se:

1. Referuar Shtojcës 7 të DST-së, pika 2 “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, pika 2.3 “*Aftësitë teknike dhe profesionale/Kapaciteti teknik*”, në pikën 2.3.1, përcaktohet se:

   *”<u>Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën”:</u>*

a) *Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet(pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*
   ***<u>ose</u>***

b) *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).*
   *Në rastin e paraqitjes së ofertave nga bashkimi i operatorëve, pika 2.3.1, gërma “a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. ...*

   *Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar)”.*

   Nga verifikimi i dokuentacionit të ngarkuar në SPE në përmushje të këtij kriteri rezulton se, bashkimi i operatorëve ekonomik “Caushi M” SHPK dhe “K.M.K” SHPK nuk arrijnë të përmbushin një nga pikat e mësipërme.

   Konkretisht:

   Operatori ekonomik “K.M.K” SHPK, i cili sipas akt-marreveshjes (Për bashkim të përkohshëm të operatorëve ekonomik) datë 14.08.2023, do të kryejë 55.07% të punimeve**,** bazuar në nenin 88, pika 3, parargrafi i dytë i VK M-së nr.285, datë 19.05.2021, *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, në të cilin citohet:

*“Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet ngaanëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht”*

Operatori “K.M.K” SHPK. duhet të plotësojë kriterin 2.3.1/a

Asnjë nga kontratat e paraqitura në SPE nga operatori ekonomik “K.M.K” SHPK nuk e plotëson kriterin 2.3.1/a. Konkretisht:

OE “K.M.K” SHPK ka paraqitur në SPE këto kontrata:

1. Kontrata për “Parkim për bicikletat në qytet” e lidhur me dt.07.03.2019 midis “K.M.K” SHPK dhe AK Bashkia Durrës, me vlerë 202 614 lekë me tvsh – Nuk është punë e ngjashme.
2. Kontrata për “Vendosje impiante në kuzhinat e kopshteve, cerdheve e shkollave” e lidhur midis “K.M.K” SHPK dhe AK Bashkia Fier, me vlerë 2 079 924 lekë me tvsh – Nuk është punë e ngjashme.
3. Kontrata për “Rikualfikim i lulishtes në qëndër të qytetit të Elbasanit” e lidhur midis BOE “K.M.K” SHPK & “Caushi M” SHPK dhe AK Fondi Shqiptar i Zhvillimit, me vlerë 22 010 756 lekë me tvsh, ku “K.M.K” SHPK ka 97.08 % të punimeve (fitimit) – Nuk është punë e ngjashme.
4. Kontrata për “Lyerje ambieteve të godinave arsimore” e lidhur midis BOE “K.M.K” SHPK & “Sinder AB” sh.p.k. dhe AK Bashkia Durrës, datë 20.08.2018, me vlerë 4 895 796 lekë me tvsh, ku “K.M.K” ka 60 % të punimeve (fitimit) – Kontrata është realizuar ne vleren totale 4 078 870 leke pa tvsh. Nga kjo shume vetem 2 447 322 lekë pa tvsh i përkasin OE “K.M.K” SHPK.
5. Kontrata për “Rikonstruksion kopshti Neim Babameto” e lidhur midis BOE “K.M.K” SHPK & “Sinder AB” sh.p.k. & “Caushi M” SHPK dhe AK Bashkia Durrës, datë 11.04.2019, me vlerë 9 551 152 lekë me tvsh, ku “K.M.K” SHPK ka 38.39 % të punimeve (fitimit) – Kontrata është realizuar në vlerën totale 7 003 850 lekë pa tvsh (pa mobilimin). Nga kjo shumë vetëm 2 688 778 lekë pa tvsh i përkasin OE “K.M.K” SHPK.
6. Kontrata për “Ndërtimi i nyjeve sanitare përgjate plazhit” e lidhur midis BOE K.M.K. sh.p.k & “Sinder AB” sh.p.k. dhe AK Bashkia Durres, datë 01.10.2018 me vlerë 3 427 623 lekë me tvsh, ku K.M.K sh.p.k. ka 60 % të punimeve (fitimit) – Kontrata është realizuar në vlerën totale 2 856 353 lekë pa tvsh. Nga kjo shumë vetëm 1 713 811.8 lekë pa tvsh i përkasin OE K.M.K. sh.p.k.
7. Kontrata për “Riparimin e mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa” për Njësinë Administrative Nr.7, Lagjja Nr.14 (28 pallate)” e lidhur midis BOE “K.M.K” SHPK & “Caushi M” SHPK dhe AK Bashkia Tiranë, datë 29.08.2022, me vlerë 37 099 324.8 lekë

me tvsh, ku “K.M.K” SHPK ka 70.59 % të shërbimit (fitimit) – Është kontratë shërbimi dhe jo kontratë pune, pra nuk është punë e ngjashme,

8. Kontrata për “Zbatimi i projektit të kontrollit fizik të mjeteve në terminalin e trageteve” e lidhur midis BOE “K.M.K” SHPK & “Caushi M” SHPK dhe AK Autoriteti Portual Durrës, datë 13.09.2021, me vlerë 15 499 323 lekë me tvsh, ku “K.M.K” SHPK ka 55.15 % të punimeve (fitimit) – Kontrata është realizuar në vlerën totale 11 196 050 lekë pa tvsh. Nga kjo shumë vetëm 6 174 621.5 lekë pa tvsh i përkasin OE “K.M.K”. SHPK
9. Kontrata për “Rikualifikim i rrugës kryesore i fshatit Qerret, Kavajë” e lidhur midis BOE “K.M.K” SHPK & “Sinder AB” sh.p.k. dhe AK Bashkia Kavajë, datë 28.05.2019, me vlerë 13 483 111 lekë me tvsh, ku “K.M.K” SHPK ka 82.56 % të punimeve (fitimit) – Nuk është punë e ngjashme.
10. Kontrata për “Rikonstruksion i rrjetit elektrik shkolla Hasan Koçi” e lidhur midis BOE “K.M.K” SHPK & “Sinder AB” sh.p.k. dhe AK Bashkia Durrës, datë 31.07.2018 me vlerë 970 569 lekë me tvsh, ku “K.M.K” SHPK ka 50 % të punimeve (fitimit) – Nuk është punë e ngjashme.
11. Kontrata për “Rikonstruksion godina ‘Shtëpia e Foshnjës’ Shkozet” e lidhur midis BOE “K.M.K” SHPK & “Sinder AB” sh.p.k. dhe AK Bashkia Durrës, datë 25.07.2018 me vlerë 3 283 497 lekë me tvsh, ku “K.M.K” SHPK ka 50 % të punimeve (fitimit) – Kontrata është realizuar në vlerën totale 2 735 950 lekë pa tvsh. Nga kjo shumë vetëm 1 367 975 lekë pa tvsh i përkasin OE “K.M.K” SHPK sh.p.k.
12. Kontrata për “Ndërtim impianti klorinimi në ujësjellesat rajonal dhe vendosje matësash në depo” e lidhur midis “K.M.K” SHPK dhe AK Ujësjellës Kanalizime sh.a Tiranë, datë 06.11.2019, me vlerë 29 612 142 lekë me tvsh, – Kontrata është realizuar në vlerën totale 24 676 157 lekë pa tvsh.

Pra, asnjë nga kontratat e paraqitura nga operatori ekonomik “K.M.K” SHPK nuk e plotëson kriterin 2.3.1/a të DST.

2. Referuar Shtojcës 7 të DST-së, pika 2 “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, pika 2.3 ”*Aftësitë teknike dhe profesionale/Kapaciteti teknik*”, në pikën 2.3.5, përcaktohet:

”*<u>Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion:</u>*

<u>....</u>

***<u>b)</u>*** *Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion pajisjet teknike (pronësi ose me qera), të nevojshme për sigurimin teknik në kantier referuar*

*legjislacionit në fuqi, (sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit) duke përfshirë minimum edhe:*

*- Kokore, minimumi 30 copë.*

*- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila, minimumi 3 copë.*

*- Komplet i ndihmës së shpejtë, minimumi 4copë.*

*- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 3 copë.*

*- Veshjetrupi me rripa sigurie ose litarë sigurimi, për punimet në lartësi, minimumi 20 copë."*

Referuar VKM nr.285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, në nenin 88, pika 3, përcaktohet se:

"*Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe /ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje*."

Sa më lart, nga verifikimi i Formularit të Vetëdeklarimit të ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik "K.M.K" SHPK nuk është deklaruar asnjë informacion në lidhje me pajisjet teknike si: kokore dhe veshje trupi me rripa sigurie ose litarë sigurimi, për punimet në lartësi.

3. Gjithashtu, në preventivin e paraqitur në SPE (Sistemin e Prokurimit Elektronik), konkretisht:

- Zëri nr.6 në preventivin "Punime elektrike ne objektin ekzistues dhe shtesën anësore" është pasqyruar "*F.V Automat termoelektromag 4PHP-**400**/380V",* ndërkohë që ky zë në preventivin e AK është kërkuar *"F.V Automat termoelektromag 4PHP-**40**/380 V"*
- Zëri nr.35 në preventivin "Punime elektrike ne objektin ekzistues dhe shtesën anësore" është pasqyruar *"F.v elektroda tokezimi te xinguara profil : l=**50**m",* ndërkohë që ky zë në preventivin e AK është kërkuar *"F.v elektroda tokezimi te xinguara profil : l=**150**m"*
- Zëri nr.40 në preventivin "Punime elektrike në objektin ekzistues dhe shtesën anësore" është pasqyruar "F.*v pusete PVC 40x40x40 me kapak te forte RIC **108**+1086*", ndërkohë që ky zë në preventivin e AK është kërkuar *"F.v pusete PVC 40x40x40 me kapak te forte RIC **1084**+1086".*
- Zëri nr.29 në preventivin "Punime elektrike palestra" është pasqyruar "F.v elektroda tokezimi te xinguara profil : l=**50m**", ndërkohë që ky zë në preventivin e AK është kërkuar "F.v elektroda tokezimi te xinguara profil, e bakerizuar : l=**1.5m**".

- Zëri nr.31 në preventivin “Punime elektrike palestra” është pasqyruar “F.v pusete PVC 40x40x40 me kapak te forte RIC **108**+1086”, ndërkohë që ky zë në preventivin e AK është kërkuar *“*F.v pusete PVC 40x40x40 me kapak te forte RIC **1084**+1086”
- Zëri nr.30 në preventivin “Punime hidroteknike dhe mnz ne objektin ekzistues dhe shtesen anesor” është pasqyruar **sasia 10 m3**, ndërkohë që ky zë në preventivin e AK është kërkuar **sasia 23 m3.**
- Zëri nr.3 në preventivin “Punime rrethimi” është pasqyruar **sasia 1 ton** ndërkohë që për këtë zë në preventivin e AK është kërkuar **sasia 0.5 ton.**
- Zëri nr.1 në preventivin “SISITEMI I LAJMERIMIT ZANOR DHE EMERGJENCES (AUDIO)” është pasqyruar “F.V Kabell audio FT100MI 2x2.5mm2”, ndërkohë që ky zë në preventivin e AK është kërkuar *“*F.V Kabell audio FT**G**10OMI 2x2.5mm2”
- Zëri nr.10 në preventivin “*F.V Njesi qendrore kontrolli Central controllingt unit (Digital Int.System Manager)sipas certifikimit EN 54-16 dhe ne perputhje EN 60849, t, me 6 zona dhe me mundesi zgjerimi, 6 hyrje audio, me mundesi komunikimi ne rrjet me centralin e zjarrit apo zgjerimi (sipas sistemit te zgjedhur)”* është pasqyruar “F.V Kabell audio FT100MI 2x2.5mm2”, ndërkohë që ky zë në preventivin e AK është kërkuar *“F.V Njesi qendrore kontrolli Central controllingt unit (Digital Int.SystemManager)sipas certifikimit EN 54-16 dhe ne perputhje EN 60849, t, me 6 zona dhe me mundesi zgjerimi, 6 hyrje audio,**4 dalje audio,** me mundesi komunikimi ne rrjet me centralin e zjarrit apo zgjerimi (sipas sistemit te zgjedhur)***)**”/
- Zëri nr.5 në preventivin **“**Punime te brendshme ndertimore ne objektin ekzistues, A/2. Punime murature dhe betoni**”** është pasqyruar “*Mur me tulle me **65** vrima, t=12 cm, llac perzier M15”*, ndërkohë që ky zë në preventivin e AK është kërkuar “Mur me tulle me **6** vrima, t=12 cm, **h=3m** llac perzier M15”.
- Zëri nr.2 në preventivin “Punime te brendshme ndertimore ne objektin ekzistues, A/5. Punime fasade” është pasqyruar “*Boje vaji siperfaqe metalike me **llamarine xingat 33 cm***”, ndërkohë që ky zë në preventivin e AK është kërkuar “*Boje vaji siperfaqe metalike*”, Përvec emërtimit sasia dhe njësia e paraqitur nga BOE është **8 ml,** ndërkohë që ky zë në preventivin e AK është **24 m2.**
- Zëri nr.2 në preventivin “Punine ndertimore ne shtesen anesore. Punime murature dhe betoni” është pasqyruar “*Mur me tulle me **65** vrima, t=12 cm, llac perzier M15*”, ndërkohë që ky zë në preventivin e AK është kërkuar “*Mur me tulle me **6** vrima, t=12 cm, **h=3m** llac perzier M15”.*
- Zëri nr.2 në preventivin “Punime ndertimore ne shtesen anësore,Palestra4. Punime fasade” është pasqyruar “Boje vaji siperfaqe metalike me **llamarine xingat 33 cm**”, ndërkohë që ky zë në preventivin e AK është kërkuar “*Boje vaji siperfaqe metalike*”, Përvec emërtimit njësia e paraqitur nga BOE është **ml,** ndërkohë që ky zë në preventivin e AK është **m2.**

- Zërit nr.6 në preventivin “Punime ndertimore ne shtesen anësore,Palestra4. Punime fasade” I është ndryshuar numri i analizës.

- Nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik **“FRONTIER CONSTRUCTION” SHPK, me NUIS M11811020Q**, paraqitur në SPE (Sistemin e Prokurimit Elektronik), KVO konstatoi se dokumenti i vetëm i ngarkuar në SPE me emërtimin “*Formulari_ofertes*” nuk ka lidhje me objektin e procedurës së prokurimit. Pra, ky operator ekonomik nuk ka parqaqitur asnjë dokument për këtë procedurë prokurimi.

- Nga verifikimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomik BOE: **“INA” SHPK, me NUIS J61814009W dhe “XHENGO” SHPK me NUIS J64103171M**, paraqitur në SPE (Sistemin e Prokurimit Elektronik), KVO konstatoi se:

1. Referuar Shtojcës 7 të DST-së, pika 2 “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, pika 2.2 “*Kapaciteti ekonomik dhe financiar*”, pika 2.2.1, kërkohet**:**

*”**Kopje të çertifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve të fundit (2021, 2022), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre**. Nëse operatori ekonomik ofertues eshte ne kushtet e parashikuara nga neni 41, pika ”c”, e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet te shoqerohet me akt-ekspertizen e kryer nga eksperti kontabel.”*

Operatori ekonomik “XHENGO” SHPK me NUIS J64103171M, nuk e ka përmbushur këtë kriter pasi bilanci financiar për vitin 2022 nuk eshtë i konfirmuar nga Administrata Tatimore.

2. Referuar Shtojcës 7 të DST-së, pika 2 “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, pika 2.3 “*Aftësitë teknike dhe profesionale/Kapaciteti teknik*”, në pikën2.3.1, përcaktohet:

*”<u>Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën”:</u>*

a) *Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet(pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

***<u>ose</u>***

b) *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).”*

***Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.***

***Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/vë ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:***

i) *Për kontratat e realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik, duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve:*

1. ***Formular vleresimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.11, shoqëruar me:***
2. *Kontratën/at eSipërmarrjes;*
3. *Situacionin përfundimtar të objektit;*
4. *Aktin e kolaudimit;*

*Formulari i vlerësimit duhet të përcaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.*

ii) *Për kontratat e realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:*

1. ***Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.11, shoqëruar me:***
2. *Kontratën/at e Sipërmarrjes;*
3. *Situacionin përfundimtar të objektit;*
4. *Aktin e kolaudimit;*
5. *Fatura tatimore përfundimtare. “*

Operatorit ekonomik “XHENGO” SHPK në përmbushje të këtij kriteri, ka ngarkuar në SPE dokumentin me emërtimin “*PUNIM_I_NGJASHEM_XHENGO*”, por nga verifikimi i kryer rezulton se nuk është paraqitur dokumenti: “*Formular vleresimi per realizimin e punimeve...”* siçkërkohetnë DST.

3. Gjithashtu, në Preventivin e paraqitur në SPE (Sistemin e Prokurimit Elektronik), konkretisht:

- Zëri nr.5 në preventivin "Punimëlektrike" është pasqyruar "Transport *material ndertimi, dheu me auto deri **0.8** km* ", ndërkohë që ky zë në preventivin e AK është kërkuar "*Transport material ndertimi, dheu me auto deri **8.0** km".*
- Zëri nr.2 në preventivin "PUNIME ELEKTRIKE" është pasqyruar "*F.v Automat termoelektromag. 4P HP-160A/380**A**",* ndërkohë që ky zë në preventivin e AK është kërkuar "F.*v Automat termoelektromag. 4P HP-160A/380**V***".
- Zëri nr.3 në preventivin "PUNIME ELEKTRIKE" është pasqyruar "*F.v Automat termoelektromag. 4P HP-63A/380**A** ",* ndërkohë që ky zë në preventivin e AK është kërkuar "*F.v Automat termoelektromag. 4P HP-63A/380**V***".
- Zërit nr.13 në preventivin "PUNIME ELEKTRIKE" i është ndryshuar numri i analizës.
- Zëri nr.25 në preventivin "PUNIME ELEKTRIKE" është pasqyruar "*F.vNdricues tip plafoniere emergjence **LED** 1x18w; IP-65",* ndërkohë që ky zë në preventivin e AK është kërkuar *"F.vNdricues tip plafoniere emergjence 1x18w; IP-65*".
- Zëri nr.30 në preventivin "PUNIME ELEKTRIKE" është pasqyruar "*F.v **ne toke kabllo** Cu fuqie me izolim prej gome per ndricim ne tubot e vendosur me pare seksion 16mm²* ", ndërkohë që ky zë në preventivin e AK është kërkuar *"F.v **percjelles cu** teizoluar prej gome per ndricim ne tubot e vendosur me pare seksion 16mm²*".
- Zërit nr.6 në preventivin "PUNIME ELEKTRIKE, PALESTRA" i është ndryshuar numri i analizës.
- Zëri nr.24 në preventivin "PUNIME ELEKTRIKE, PALESTRA" është pasqyruar "*F.v Ndricues spot tavanor LED **1x13W IP-20**",* ndërkohë që ky zë në preventivin e AK është kërkuar "*F.v Ndricues spot tavanor LED **1x3W IP-20*** ²".

❖ Nga verifikimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomik BOE: **"JOGI" SHPK, me NUIS J63229478K, "COGREN" SHPK me NUIS J74818825K dhe "SPEKTRI" SHPK me NUIS J62903555F**, paraqitur në SPE (Sistemin e Prokurimit Elektronik), KVO konstatoi se:

1. Referuar Shtojcës 8, Pjesa II "*Shkaqet e përjashtimit*", seksioniB "*DEKLARATA, Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura*", pika 6: "*Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):*

   a) *Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;* ☐

   b) *Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se*

*në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit)□."*

operatori ekonomik "COGREN" SHPK dhe "SPEKTRI" SHPKnuk ka klikuar asnjë nga alternativat e përcaktuara në këtë pikë duke mos deklaruar informacionin e kërkuar.

2. Referuar Shtojcës 7 të DST-së, pika 2 "*Kriteret e veçanta të kualifikimit*", pika 2.3 "*Aftësitë teknike dhe profesionale/Kapaciteti teknik*", nëpikën 2.3.1, përcaktohet:

   *"<u>Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën":</u>*

c) *Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet(pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

***<u>ose</u>***

d) *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).*

   .....

   ....

*Në rastin e paraqitjes së ofertave nga bashkimi i operatorëve, pika 2.3.1,gërma "a" plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.*

*Kurse pika 2.3.1 gërma "b" duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, "Përmiratimin e rregullavetëprokurimitpublik", i ndryshuar)".*

Referuar dokumentacionit të ngarkuar në SPE, konkretisht, marrveshjes së bashkepnimit, operatori ekonomik "COGREN" SHPK me NUIS L91426009G, ka përqindjen më të madhe të pjesmarrjes në bashkim. Gjithashtu, nga ana e operatorit ekonomik "COGREN" SHPK është ngarkuar në SPE një kontratë e vetme.

Sa më sipër, në kushtet kur operatori ekonomik **"**COGREN" SHPK",ka përqindjen më të madhe të pjesmarrjes në bashkim, si dhe ka ngarkuar në SPE një kontratë të vetme, duhet të plotësojpikën 2.3.1, gërma "a", porngaverifikimiikryerrezulton se vlera e kësajkontrateështëmë e

vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

3. Referuar Shtojcës 7 të DST-së, pika 2 "*Kriteret e veçanta të kualifikimit*", pika 2.3"*Aftësitë teknike dhe profesionale/Kapaciteti teknik*", në pikën 2.3.4 **"***Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës"*, përcaktohet:
   *"Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se disponon licence profesonale për zbatim punimesh në ndertim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008, "Përmiratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi",*
   .....

- ***Për punimet special të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:***

1. *N.S. – 2 / Klasifikimi A (Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanderi, mirmbajtje e tyre)*
2. *N.S. – 4 / Klasifikimi A (Punimeri finitur të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës Teknik e ndërtuese)*
3. *N.S. – 8 / Klasifikimi A (Ndërtime parafabrikate betonarme, struktura metalike dhe druri)*
4. *N.S. – 14 / Klasifikimi A (Impiante të brendeshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV)".*

Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik "COGREN" SHPK, për përmushjen e këtij kriteri, duke marrë parasysh marrëveshjen e bashkëpunimit për të realizuar 45% të cdo zëri të parashikuar në preventive duhet të ketë të gjitha pikat e licencës të kërkuara në DST. Nga verifikimi i kryer rezulton se ky operator ekonomik nuk është i pajisur me licensën "N.S. – 8 / Klasifikimi A (Ndërtime parafabrikate betonarme, struktura metalike dhe druri").

5. Referuar Shtojcës 7 të DST-së, pika 2 "*Kriteret e veçanta të kualifikimit*", pika 2.3"*Aftësitë teknike dhe profesionale/Kapaciteti teknik*", operatori ekonomik "COGREN" SHPK, në përmbushje të kriterit 2.3.4**"***Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës"*, ku përcaktohet:

*"Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se disponon licence profesonale për zbatim punimesh në ndertim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërise, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008, "Përmiratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtarin dertimi",* ka dorëzuar Licencë NZ.2944/20, datë 07.10.2019, në emër të subjektit "COGREN", me drejtues ligjorë Z. Eduart Çepe, ndërkohë nga verifikimi i Ekstraktit Historik e Rregjistrit Tregtarë të operatorit ekonomik "*COGREN*", në faqen zyrtare të QKB u konstatua, se më date 12.10.2022, me çështjen nr CN-013353-10-22, ky subjekt ka kryer ndryshimet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit të administratirit të shoqërisë i shte Z. Eduart Çepe, bëhet Znj. Fotina Rondo nga data 12.10.2022 deri në datën12.10.2027, ndërsa në LicensënNZ.2944/20, datë 07.10.2019, drejtues ligjorë i shoqërisë figuron Z. Eduart Çepe.
Referua VKM nr. 42, datë 16.01.2008, "*Për Miratimin e Rregullores për Kriteret dhe Procedurat e Dhënies së Licencave Profesionale të Zbatimit, Klasifikimit dhe Disiplinimit të Subjekteve Juridike, që Ushtrojnë Veprimtari Ndërtimi*", i ndryshuar, kreu II, pika 5, germen "a", sanksionohet se çdo subject i licensuar në zbatim brenda 30 ditëve, ka detyrimin të depozitojë kërkesën për përditësimin e të dhënave që nuk sjellin ndryshim në klasifikim. Një nga ndryshimet e parashikuara në gërmën "b" të pikës 5 të VKM nr. 42 është pikërisht edhe ndryshimi apo shtesa e drejtuesit /ve ligjor të shoqërisë.

4. Gjithashtu, në Preventivin e paraqitur në SPE (Sistemin e Prokurimit Elektronik), konkretisht

- Zëri nr.9, në preventivin "*Palestra e shkolles, Punimendertimi, Punimeshtresash"* është pasqyruar "*Shtrese avullizoluese gjeotekstil* ***rmaircro I I V****"*, ndërkohë që ky zë në preventivin e AK është kërkuar "*Shtrese avullizoluese gjeotekstil*".
- Zëri nr.4 në preventivin "Palestra e shkolles, Punime te brendeshme ndertimore" është pasqyruar "*Suva trare e kollona h-4m me krah* ***me flë*** *toperzier M25*", ndërkohë që ky zë në preventivin e AK është kërkuar "*Suva trare e kollona h-4m me krah* ***me llac*** *te perzier M25".*
- Zërit nr.5 në preventivin "Palestra e shkolles, Punimefasade" nuk i është vendosur numri i analizës.
- Zëri nr.7 në preventivin "Punime IT, Sistemikabllimitkompiuterik" është pasqyruar "*F.V patch corda* ***FTP*** *0.5m"*, ndërkohë që ky zë në preventivin e AK është kërkuar "*F.V patch corda 0.5m".*

- ❖ Nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik **"LEON KONSTRUKSION" SHPK me NUIS K71820009I**, paraqitur në SPE (Sistemin e Prokurimit Elektronik), KVO konstatoi se:

Në Preventivin e paraqitur në SPE (Sistemin e Prokurimit Elektronik), konkretisht: *(Punime elektrike në objektin ekzistues dhe shtesën anësore*), emërtimi i punimeve: "*PUNIME ELEKTRIKE PALESTRA",* i cili mbyllet me zërin me numër rendor 39, rezulton të jenë shtuar edhe pesë zëra të tjerë (zëra të përsëritur).

- Nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik **"MODESTE" SHPK me NUIS J62903413B**, paraqitur në SPE (Sistemin e Prokurimit Elektronik), KVO konstatoi se:

1. Në Preventivin e paraqitur në SPE (Sistemin e Prokurimit Elektronik), konkretisht: *(Punime hidraulike dhe mnz në objektin ekzistues dhe shtesën anësore*),
   - emërtimi i punimeve: "*Furnizim me ujë sanitar dhe kanalizimi i ujrave të zeza":*
     - njësia për zërin me numër rendor 15 (pesëmbëdhjetë) është pasqyruar *"copë"* ndërkohë që njësia për këtë zë në preventivin e AK është kërkuar *"ml".*
     - është shtuar zëri me numër rendor 35 *"Elektroda togëzimi, profili zingato e bakerizuar, L=1.5 m",* zë i cili nuk ekziston në në preventivin e AK.
     - zëri me numër rendor 46 (dyzetë e gjashtë) është pasqyruar *"Llampë sinjalizimi zjarri"* ndërkohë që ky zë në preventivin e AK është kërkuar *"Buton sinjalizimi zjarri".*
   - emërtimi i punimeve: "*Furnizim me ujë sanitar dhe kanalizimi i ujrave të zeza":*
     - mungon zeri "Përcjelës CU-1X1.5 $mm^2$, me numër rendor 34 (tridhjetë e katër) sipas preventivit të AK.
     - zëri me numër rendor 46 (dyzetë e gjashtë) është pasqyruar *"Llampë sinjalizimi zjarri"* ndërkohë që ky zë në preventivin e AK është kërkuar *"Buton sinjalizimi zjarri".*
     - 

- Nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik **"NIKA" SHPK, me NUIS J76705047U**, paraqitur në SPE (Sistemin e Prokurimit Elektronik), KVO konstatoi se:

Në Preventivin e paraqitur në SPE (Sistemin e Prokurimit Elektronik), konkretisht: *(Punime IT në objektin ekzistues dhe shtesën anësore*), emërtimi i punimeve: "*SISTEMI I SURVEJIMIT ME KAMERA*", për zërin "*F.V.Tubo Plastike 0 31-36.*" me numër rendor 2, nuk është vendosur çmim.

Referuar përcaktimeve të bëra ne Shtojcën 2 "*Lista e çmimeve sipas zërave të prevetivit*", sqarohet se:

"*Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës*."

****

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin **bashkimin e operatoreve ekonomike** “AIDA CONSTRUCTION” SHPK me NUIS M03116403L dhe “EUROVIA **”**SHPKNJ me NUIS L91426009G**,** me adrese: “Fier, Rr BRIGADA XI SULMUESE, LAGJIA APOLONIA, pallati ne krah te Drejtorise Rajonale te Tatimeve, 9301, Bashkia Fier” & “Tirane, Rruga Abdyl Frasheri, Shkalla 1, Apartamenti 18, Zona Kadastrale 8270”, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **42 738 983.71** (*dyzet e dy milion e shtatëqind e tridhjetë e tetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre pikë shtatëdhjetë e një*) **lekë pa TVSH** dhe prej **51 286 780.46** (*pesëdhjetë e një milion e dyqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë presje dyzetë e gjashtë)* **lekë me TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë autoritetit kontraktor Bashkia Fier Lagja “Kastriot”, Rruga “Ramiz Aranitasi”, Fier **,** per te lidhur kontraten brenda **10 (dhjete)** ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraprak)

PO x JO□

*Nëse Po* (bazuar ne Vendimin e Komisionit te Prokurimit Publik *nr.1013/2023 ,ne. 2175/5 prot, date 09.10.2023*)

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**ZYRTARI I AUTORIZUAR**

**Zv.Kryetari**

**____________________**

**Andius OLLDASHI**